

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7993
E shtunë, 15 shkurt 2025
Çmimi 0.50 €

Çitaku reagon ashpër ndaj
Speciales: Sa duhet të rëndohet
shëndeti i babait të Thaçit që
t'ia lejojnë vizitën? | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

JANË NUMËRUAR VOTAT E KANDIDATËVE PËR DEPUTET
NË KATËR KOMUNA TË KOSOVËS | FAQE 4-5

NUMËROHEN VOTAT VETËM NË 386 VENDVOTIME



Më 9 shkurt janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në Kosovë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se deri më tani ka numëruar votat në vetëm 386 vendvotime nga 2 533

sa janë në gjithë Kosovën. Po ashtu, KQZ-ja ka njoftuar se janë numëruar votat e kandidatëve për deputetë në Han të Elezit, Shtërpcë, Partesh dhe Ranillug. Por në opinion

është zbehur besueshmëria e procesit zgjedhor për shkak të rënies së serverit dhe uebfaqes zyrtare të KQZ-së, vonesave në numërimin e votave të kandidatëve etj.

ZËVENDËSSEKRETARJA E NATO-s: PAS FORMIMIT TË QEVERISË SË RE, DUHET PËRPARIM NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI F.3



OSMANI TAKOHET ME SORENSENIN: TË PUNOJMË QË DIALOGU TË PËRMBYLLET ME NJOHJE TË NDËRSJELLË F.3



OPINION

ECURIA HISTORIKE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS F.6

Shkruan:
Hasan MUJAJ



AKTUALE



MË 17 SHKURT DO TË PARAKALOJNË FSK-JA DHE POLICIA E KOSOVËS F.8

SHTËPIA E BARDHË E TRUMPIT SI TERRITOR I RI PËR BE-në F.2

UP-ja FESTON 55-VJETORIN: NDEROHET E KALUARA DHE E ARDHMJA F.2

EKONOMI



AKP-ja I NDRYSHON RREGULLAT E SHITJES F.8

NË MAQEDONINË E VERIUT DISKUTOHET PËR MODELIN E MBËSHTETJES PËR SEKTORIN PRIVAT PËRMES PARTNERITETIT PUBLIKO-PRIVAT F.8

SPORT

SOT DERBI PRISHTINA - DRITA F.8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shtëpia e Bardhë e Trumpit si territor i ri për BE-në

WASHINGTON, 14 SHKURT - Një ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump bëri me dije synimin për të vendosur tarifë prej 25-përqindësh në importet e metalit dhe aluminit, shefja ekzekutive e Bashkimit Evropian u kundërpërgjigj. "BE-ja do t'i ruajë interesat e veta ekonomike. Ne do t'i mbrojmë punëtorët, bizneset dhe konsumatorët tanë", ka thënë shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, përmes një deklarate. "Tarifat e pajustificuara ndaj BE-së nuk do të mbesin pa përgjigje. Ato do të nxisin kundërmasa të ashpra dhe proporcionale", tha ajo.

Marrëdhëniet transatlantike janë duke hyrë në një territor të ri, teksa administrata Trump përfaqon një politikë të jashtme me muskuj dhe transaksionale, me qëllim të mbrojtjes së vendeve të punës dhe industrisë amerikane, si dhe teksa tenton t'i rishkruajë rregullat për tregti ndërkombëtare.

Për armiqet sikurse Irani apo Kina, situata nuk është shumë e ndryshme prej administratave të mëparshme. Megjithatë, për aleatët dhe partnerët sikurse Bashkimi Evropian situata është e paqartë dhe shqetësuese. "Gjërat duken më pak të parashikueshme sesa në administratën e parë, apo në krahasim me shumicën e administratave të mëparshme", ka thënë Chase Foster, profesor për politikë në Kolegjin King të Londrës, i cili ka studiuar për rregulloret në mes të ShBA-së dhe BE-së. "Nëse them se do të ketë fërkim [mes Uashingtonit dhe Brukselit] e nënvlerësor situatën", ka thënë Dalibor Rohaq, hulumtues i lartë në Institutin Enterprise në Uashington, në disa përgjigje për "Radion Evropa e Lirë". "Sinjalet që vijnë prej Shteteve të Bashkuara nuk janë duke i lënë rehat liderët evropianë konvencionalë", ka thënë Rohaq.

Ndërkaq Ian Bond, zëvendës drejtor në Qendrën për Reforma Evropiane me bazë në Londër, ka theksuar se secila politikë është transaksionale, mirëpo pikëpamjet e Donald Trumpit për interesat kombëtare të Amerikës duken shumë të ngushta dhe personale. "Vitet në vijim mund të jenë shumë të rrezikshme për stabilitetin dhe sigurinë e Evropës dhe do ta tensionojnë marrëdhënien transatlantike prej së cilës kanë përfituar interesat amerikane dhe evropiane për të paktën 80 vjet", ka thënë Ian Bond.



Kujdes: Turbulencë në ardhje!

Tarifat që janë bërë të ditura vetëm dy javë pas nisjes së punës së administratës Trump - në importet e çelikut dhe aluminit ndaj partnerëve tregtarë - Kanadasë dhe Meksikës - kanë qenë të pritshme prej shumëkujt. Kanadaja dhe Meksika janë prodhues të mëdhenj të produkteve të aluminit dhe çelikut dhe eksportojnë sasi të mëdha mallrash në Shtetet e Bashkuara. Zyrtarët e Trumpit kanë dhënë sinjale se edhe tarifa të tjera do të jenë në ardhje - sidomos në makina apo kamionë që do të mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në bllokun evropian.

Trumpi ka argumentuar për kohë të gjatë se industria amerikane është duke u dëmtuar prej importeve të lira. Tarifat janë masë përmes së cilës një administratë tenton të negociojë atë që beson se është marrëveshje më e mirë për punëtorët amerikanë, për mbrojtje të vendeve të punës dhe, ndërkohë, përmes tyre rrit të hyrat nga taksat. "Unë pres një lloj lufte tregtare. Nuk do them që situata do të përshkallëzohet plotësisht, por nëse vendosen tarifa 10-20 për qind në mallrat e Evropës, pres që BE-ja të kundërpërgjigjet njëjtë", ka thënë Foster. Administrata Trump është në avantazh në krahasim me Brukselin për shkak të ekonomisë së fuqishme, ndonëse situata edhe mund të përkeqësohet nëse BE-ja vlerëson se politikat tregtare amerikane janë përçmuese. Nëse ndodh diçka e tillë, Fosteri beson se industritë evropiane dhe përkrahësit e tyre politikë mund të çojnë përpara "patriotizëm ekonomik". "Shikojeni se çfarë ka ndodhur

në Kanada". Një qasje agresive e një shteti që ndihet i sulmuar ekonomikisht, prej një shteti më të fuqishëm. Patriotizmi ekonomik është emocion që del përtej partive", ka thënë Foster, duke shtuar se prandaj mund të ndodhë që "popullata e Evropës mund t'i lë anash dallimet dhe të bashkohet dhe t'i mbrojë interesat e veta kundër Shteteve të Bashkuara, apo ndonjë shteti që mund ta ngacmojë".

Fërkimi për sektorin e teknologjisë

BE-ja e ka një qasje më agresive për rregullim të kompanive teknologjike sikurse Google dhe Apple. Vitin e kaluar është fuqizuar Akti për Tregjet Digjitale, duke shpallur gjashtë gjigantë teknologjikë si krijues monopolesh, dhe u ka kërkuar që të veprojnë në përputhje me rregulloret strikte. Pesë nga gjashtë prej tyre janë amerikane dhe njëra kineze - kompania amë e TikTokut.

Ndërkohë, shefat ekzekutivë të kompanive të mëdha amerikane përfshirë Elon Musk si shef i kompanive Tesla dhe X, e kanë përkrahur fort kthimin e Trumpit në Shtëpinë e Bardhë. Në përgjithësi, këto kompani i kanë anashkaluar rregulloret e BE-së.

Në një samit për inteligjencë artificiale të mbajtur këtë javë në Paris, në të cilin kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë amerikanë dhe evropianë, si dhe shefa të kompanive të mëdha teknologjike, nënpresidenti amerikane J.D.Vance, e ka kritikuar BE-në dhe përpjekjet e saj për të rregulluar sektorin e teknologjisë. "Ne besojmë se rregullimi i tepërt i sektorit të inteligjencës artificiale mund të shkatërrojë industrinë transformativë", ka thënë Vance, duke shtuar se: "Ne do të bëjmë çdo përpjekje që të inkurajojmë rritje pragmatike

dhe politika për inteligjencën artificiale". Ndërkaq Foster mendon që për shumë evropianë teknologjia shihet si kërcënim ekzistencial, si për kompanitë ashtu edhe për ekonomitë e tyre, për aftësinë e Evropës që të jetë konkurrenente me teknologjinë e vet, por edhe si kërcënim për demokracinë evropiane. "Nuk ka të bëjë vetëm me dezinformimin që e dimë se ekziston online, por edhe me faktin që këto kompani janë jashtë territorit të Evropës", ka thënë ai, duke shtuar se kështu që nuk e di nëse kërkesat që po shtyhen përpara prej administratës Trump do të jenë të kënaqshme për liderët evropianë.

Shtrirja e ndikimit

Ekziston edhe një pikëpyetje, nëse politika konservatore e Trumpit do t'i forcojë marrëdhëniet me liderët sikurse kryeministri hungarez, Viktor Orban apo kryeministri sllovak, Robert Fico, të cilët njihen për mesazhet populiste, të përcjella me politikë konservatore, me një qëllim të vetme: fitores në zgjedhje.

"Çfarë vërejmë tek Orban dhe Fico është që agjendat e tyre janë goxha anti-amerikane dhe përmes tyre tentojnë të forcojnë pozicionin e armiqve të ShBA-së në rajon, sikurse të Rosisë apo Kinës", ka thënë Rohaq, duke shtuar se: "Megjithatë, ata duket se e kanë të përbashkët këtë ngrohtësinë për administratën aktuale, e cila çon përpara agjendën 'Amerika e Para'".

Orbani, i cili është në telashe me BE-në për shkak të bindjeve të tij, e ka konsoliduar pushtetin me konceptin "demokracia joliberalë", duke dëmtuar pavarësinë e mediave dhe të gjykatave, dhe duke e bërë partinë e tij Fidesz, dominuese në shtet.

Nuk është sekret as entuziazmi i tij për Trumpin dhe aktivistët konservatorë në Shtetet e Bashkuara. Në ditën e zgjedhjeve në ShBA, kur Trump e ka mposhtur kundërshtaren e tij demokrate, Kamala Harris, lideri hungarez ka thënë 'Ne fituam', përmes një postimi në faqen e tij në Facebook.

Orbani "ndihet i shfajësuar dhe vetëm sa po e forcon pozicionin e tij prej 'euroskeptiku' dhe qasjen e tij joliberalë", ka thënë Zsuzsanna Vegh, prej Fondit Marshall të Shteteve të Bashkuara, me bazë në Berlin.

Ajo ka thënë në disa përgjigje për Radion Evropa e Lirë se Orbani tani ndihet se ka më shumë autoritet për t'i shtypur grupet opozitare dhe kritikët qeveritarë.

"Narrativa qeveritare është sulmi ndaj mediave të pavarura dhe organizatave joqeveritare në Hungari. Ky sinjal pritet të ndiqet prej zyrtarëve tjerë që mendojnë njëjtë brenda BE-së, dhe Robert Fico veçse i ka hyrë rrugës së njëjtë", ka thënë ajo.

Fico është figurë më ndryshe prej Orbani, ka thënë Grigorij Meseznikov, analist politik sllovak në Bratislavë. Sipas tij, Fico nuk mund të kategorizohet lehtë si politikan i krahut të djathtë. "Është e vërtetë që ai duke çuar përpara ide shumë të ngjashme me të djathtës ekstreme, por nuk është lloji i politikanit të ekstremit të djathtë. Ai ende çon përpara narrativë pro-rusë. Ai është pro-rus dhe është kundër Amerikës, që është goxha paradoksale", ka thënë Meseznikov.

Sipas tij, në përgjithësi, ai ka qasje pozitive ndaj Trumpit. "Mendoj që e ka mirëpritur fitoren e tij në zgjedhjet presidenciale, pavarësisht bindjeve të tij kundër Amerikës", ka thënë ai.

Javën e kaluar, Fico e ka publikuar një letër të hapur për Elon Muskun, i cili ka bërë përpjekje për të mbyllur Agjencinë amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), që të ndajë me të informacione për "organizatat joqeveritare, mediat dhe gazetarët individuale" që kanë pranuar para prej USAID-it.

Meseznikov e ka quajtur letrën "shaka" meqë, sipas tij, USAID-i ka pasur prani minimale në Sllovakia që disa vjet. "Unë pres që Shtëpia e Bardhë e Trumpit të bëjë më të mirën që t'i rrisë popullistët e krahut të djathtë në Evropë, jo vetëm ata që janë në pushtet, sikurse Orban dhe Fico, por edhe të tjerë", ka thënë Bond, duke përmendur si shembull partinë gjermane, Alternativa për Gjermaninë, apo Marshin Kombëtar të Francës.

Konjufca pret në takim të dërguarin e posaçëm të Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, flasin për situatën në Kosovë

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim të Dërguarin e Posaçëm të Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, Anzej Franges. Në këtë takim, kryetari Konjufca e njoftoi Frangesin me aktualitetin politik në

Kosovë, e cila sapo ka kaluar nëpër një periudhë fushate elektorale dhe zgjedhesh parlamentare, që do ta përcaktojë legjislaturën e re të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konjufca shprehu vlerësim për raportet midis Republikës së Kosovës dhe Sllovenisë, duke i konsideruar

të rëndësishme, sidomos në perspektivën e ambicieve tona të integritetit evropian apo anëtarësimit të vendit tonë në strukturat ndërkombëtare. Më tutje, ai shtoi se dy vendet tona ndajnë vlera, qëllime dhe interesa të përbashkëta, prandaj duke ruajtur

angazhimin dhe gatishmërinë tonë, duhet t'i përdorim të gjitha mundësitë për ta thelluar gjithnjë e më shumë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e shkëlqyera në të gjitha drejtësit. Konjufca e falënderoi Anzej Franges për vizitën dhe për diskutimin e frytshëm, që



zhvillohet përbrenda kuadrit të partneritetit të vyer e të palëkundur midis vendeve tona.

Sorenseni diskuton në Paris dhe Berlin për mënyrat e avancimit të dialogut Kosovë - Serbi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PARIS, 14 SHKURT - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Peter Sorensen, ka bërë me dije se në dy ditët e fundit ka biseduar në Paris dhe Berlin për mënyrat se si mund të avancojë procesi i dialogut. "Mirënjohës për mbështetjen e tyre të plotë për përpjekjet e mia", ka thënë Sorenseni përmes një postimi në "X", teksa ka publikuar fotografi me zyrtarë të të dyja shteteve. Deklarata e tij ka ardhur në ditën kur kryediplomatja e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, ka thënë se ka dëgjuar kritika rreth formatit të deritashëm të dialogut mes dy vendeve, dhe ka paralajmëruar që së bashku me Sorensenin do të analizojnë mundësinë si mund të bëhet proces funksional. "Sapo kemi emëruar një përfaqësues të

posaçëm për dialog mes Beogradit dhe Prishtinës. Dhe, unë do të ulem me të në mars, për të parë se si do të vazhdojmë me këtë", tha Kallas në një bisedë të përbashkët me grupin "Redaksia Evropiane", ku bëjnë pjesë rreth 20 agjenci evropiane të lajmeve. "Unë vërtet dua të shikoj se si mund ta bëjmë këtë funksional. E kam adresuar këtë edhe me ministrin e Jashtëm të Serbisë. Dhe ai më ka thënë se është i gatshëm vërtet të investojnë kohë në normalizimin", tha Kallasi.

Kosova dhe Serbia dialogojnë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian që nga viti 2011. Në vitet e fundit dialogu është zhvilluar në nivel të lartë mes liderëve të dy vendeve dhe në nivel kryenegociatorësh.

Gjatë mandatit gati pesëvjeçar të të dërguarit të kaluar të bllokut, Miroslav Lajçakut, në fillim të vitit 2023 Kosova dhe



Serbia arritën marrëveshjen për normalizim të marrëdhënieve. Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjrisht e detyrueshme për palët, ka thënë blloku evropian, i cili i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnjsjen e zbatimit të paktit. Në të kaluarën, liderë të Kosovës, nisur nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani e deri te kryeministri Albin Kurti, e kanë kritikuar Lajçakun për qasje të pabalancuar në dialog dhe për rreshtim me raste kah Serbia.

Pasardhësi i tij, Peter Sorensen

nga Danimarka, e ka nisur zyrtarisht punën më 1 shkurt. Nuk është e qartë se kur mund ta mbajë takimin e parë Sorenseni në kuadër të dialogut, duke qenë se Kosova mbajti zgjedhje më 9 shkurt dhe pritet ta formojë qeverinë e re, ndërsa Serbia përballet me paqartësi politike pas dorëheqjes së kryeministrit. Kallasi tha se po pret derisa Kosova të formojë qeveri të re, për të "parë se si të vazhdojmë tutje".

Sorenseni, për dallim nga paraardhësi i tij, do të merret vetëm me dialogun ndërmjet dy vendeve fqinje, e jo edhe me çështje rajonale të Ballkanit.

Emërimi i Sorensenit është parë si pozitiv, duke qenë se 57-vjeçari e njëh rajonin. Diplomati prej shumë vitesh, ai ishte angazhuar në Kosovë në kuadër të Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si dhe në

role të tjera, në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Sipas njohësve të politikës, ai nuk ka nevojë të informohet paraprakisht për njerëzit apo faktet historike të rajonit, sepse tashmë ka pasur mundësinë ta krijojë një pasqyrë nga afër.

Një tjetër argument që është përmendur si pozitiv nga zyrtarët në Prishtinë është se ai është nga Danimarka, vend që një shtetësinë e Kosovës, dhe se do të ketë qasje të barabartë në dialog.

Kallasi përsëriti të enjten se normalizimi i marrëdhënieve fqinjësore është i nevojshëm për Kosovën dhe Serbinë për të ecur përpara. "Nëse ato mendojnë se mund të lëvizin në rrugëtimin evropian pa normalizimin e marrëdhënieve, atëherë unë mendoj se një gjë e tillë nuk është e mundur", ka thënë ajo.

Zëvendëssekretarja e NATO-s: Pas formimit të qeverisë së re, duhet përparim në dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 14 SHKURT - Zëvendëssekretarja e përgjithshme e NATO-s, Radmilla Shekerinska, ka theksuar rëndësinë e stabilitetit dhe procesit paszgjedhor në Kosovë, por edhe në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ajo për RTV Dukagjinë ka theksuar se NATO nuk ndërhyr në politikën vendase, por pret një qeveri funksionale dhe përparim në dialogun me Serbinë, të cilin e sheh si thelbësor për stabilitetin rajonal. "Në përgjithësi kemi kaluar në një situatë të paqëndrueshme dhe kur ka

zgjedhje në rajon, sikur këto, duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Por, fatmirësisht, zgjedhjet kaluan dhe nuk kishte ndikimin direkt në stabilitet. Është e qartë që qytetarët ta ushtronin të drejtën e tyre të votës dhe tani definitivisht është procesi pas zgjedhjeve që ka rëndësi më së shumti. Por kjo nuk është diçka që NATO as ndërhyr e as ndikon. Ne presim që të zgjidhet qeveria që përfaqëson institucionet e Kosovës. Dhe, në fakt, ne duam lëvizje në çështjen e dialogut, progres në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Ne



besojmë që ky është investim i duhur në stabilitetin e mëtutjeshëm të rajonit", ka

thënë Shekerinska.

Sa i përket sigurisë, Shekerinska rikujtoi se NATO-ja ka rritur numrin e trupave të KFOR-it si përgjigje ndaj disa ngjarjeve - si sulmi terrorist në Banjaskë të Zveçanit. "Ajo çfarë kemi bërë pas disa incidenteve që ndodhën në Kosovë, është sigurisht që t'i shtojmë trupat tanë të KFOR-it. Dhe kjo mendoj që flet shumë rreth përkushtimit të NATO-s, investimeve që kemi atje dhe ta përkrahim dialogun politik", ka shtuar zëvendëssekretarja e përgjithshme e NATO-s.

Lidhur me anëtarësimin e

Kosovës në NATO, Shekerinska theksoi se kjo është një çështje që kërkon përparim të mëtejshëm në dialogun Kosovë - Serbi. "Kur bëhet fjalë për anëtarësimin në NATO kjo, në fakt, është fazë tjetër dhe për këtë me të vërtetë na duhet të shohim përparim në dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Prandaj edhe e përkrahim dialogun e udhëhequr nga BE-ja. Duam të ecim përpara dhe të diskutojmë çështje që janë në interes të të gjithëve në rajon", ka theksuar zëvendëssekretarja e përgjithshme e NATO-s.

Osmani takohet me Sorensenin: Të punojmë që dialogu të përmbillet me njohje të ndërsjellë

MUNIH, 14 SHKURT - Presidentja Vjosa Osmani është takuar për të parën herë me përfaqësuesin e ri të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen. Osmani ka thënë se bashkë

me Sorensenin kanë diskutuar për zhvillimet e fundit në vend dhe pritshmëritë nga dialogu i Brukselit. "Në takimin tim të parë me përfaqësuesin e ri të BE-së për Dialog, Peter Sorensen, diskutuam mbi

zhvillimet e fundit në vend dhe pritshmëritë nga dialogu i Brukselit", ka shkruar Osmani në "Facebook".

E para e vendit ka thënë se do të punohet fort me aleatët që procesi i dialogut të përmbillet me njohje të ndërsjellë. "Do të

vazhdojmë të punojmë me aleatët tanë që ky proces të përmbillet me njohje të ndërsjellë dhe mbrojtjen e sovranitetit, kushtetutshmërisë dhe integritetit territorial të Republikës sonë", ka shkruar Osmani.





JANË NUMËRUAR VOTAT E KANDIDATËVE PËR DEPUTET NË KATËR KOMUNA TË KOSOVËS

NUMËROHEN VOTAT VETËM NË 386 VENDVOTIME

Më 9 shkurt janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në Kosovë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se deri më tani ka numëruar votat në vetëm 386 vendvotime nga 2 533 sa janë në gjithë Kosovën. Po ashtu, KQZ-ja ka njoftuar se janë numëruar votat e kandidatëve për deputetë në Han të Elezit, Shtërpçë, Partesh dhe Ranillug. Por në opinion është zbehur besueshmëria e procesit zgjedhor për shkak të rënies së serverit dhe uebfaqes zyrtare të KQZ-së, vonesave në numërimin e votave të kandidatëve etj.

ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës i ka siguruar 17.67 për qind të votave. Koalicioni mes Aleancës për Ardhmëninë e Kosovës dhe NISMA-s 7.45 për qind të votave. Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës - 4.45 për qind të votave.

Çfarë e gjeti KQZ-në?

Nëse qytetarët dhe institucionet e Kosovës janë mburrur për diçka jashtë vendit, ka qenë organizimi dhe mbarëvajtja e proceseve zgjedhore ndër vite, pavarësisht se kush ka fituar. Por, jo edhe këtë herë. Jo me entuziazmin e njëjtë, të paktën. Pakënaqësitë janë rritur edhe për faktin se, për dallim prej viteve të fundit, kur zgjedhjet janë mbajtur para kohe dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pasur vetëm një muaj e pak për t'i bërë të gjitha përgatitjet, këtë herë zgjedhjet e 9 shkurtit kanë qenë të rregullta, dhe KQZ-ja i ka pasur gjashtë muaj për t'u siguruar që gjithçka do të shkonte mirë. Rënia e serverit dhe e uebfaqes zyrtare të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, vonesat në numërimin e votave për kandidatët për deputetë, telashet me blerjen e kamerave dhe mostrajnimi i duhur i

stafit, janë vetëm disa prej problemeve që kanë dalë gjatë rrugës, të cilat, siç thonë disa, ia kanë zbehur besueshmërinë gjithë procesit. KQZ-ja e ka arsytuar nisjen me vonesë të numërimit të votave, duke thënë se procesi i ri i numërimit – siç e parasheh Ligji i ri për Zgjedhjet – është kompleks dhe se institucioni është duke kaluar nëpër të për herë të parë. Organizatat joqeveritare, që kanë mbikëqyruar procesin zgjedhor, kanë bërë me gisht drejt KQZ-së. Rrjeti i tyre, Demokracia në Veprim (DnV), ka vlerësuar se problemet me serverë kanë krijuar konfuzion dhe kanë ulur besimin e publikut në transparencën e procesit. DnV-ja ka përmendur edhe vonesa në miratimin e përbërjes së Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe në procesin e tenderimit dhe përdorimit të matikulimit, si metodë për identifikimin e votuesve. Partitë opozitare fajësojnë pushtetin. Kandidati i AAK-së për kryeministër, Ramush Haradinaj, ka thënë se fakti që rezultati preliminar i zgjedhjeve nuk është ditur as pas 24 orëve, “për herë të parë në historinë e Kosovës, është pasojë e drejtpërdrejtë e zëvendësimit të kadrove profesionale me militantë

partiakë dhe e angazhimit të kompanive të teknologjisë informative përmes tenderëve të dyshimtë njëburimorë”. Qeveria e Kosovës ka thënë se nuk është përgjegjëse për serverët e KQZ-së dhe se softueri i është dhuruar KQZ-së nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ndërsa akuzat drejt ekzekutivit i ka konsideruar përpjekje të ulët “për të shkaktuar huti, me qëllim që të ulet besimi në procesin zgjedhor dhe në rezultatin e tij”. Kompania “Cactus”, e cila është kontraktuar për ta zhvilluar softuerin për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të KQZ-së, ka thënë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, Arianit Koci, se aplikacioni është i vendosur në infrastrukturën qeveritare, e cila menaxhohet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), dhe se siguria, luftimi i krimin kibernetik, por edhe funksionimi i faqes, janë përgjegjësi e agjencisë shtetërore. Kritika për mbarëvajtjen e zgjedhjeve ka pasur edhe misioni i Bashkimit Evropian, i cili e ka monitoruar procesin. “KQZ-ja është përballur me vonesa të konsiderueshme në përgatitje, në aspektin teknik dhe administrativ. Vështirësitë në procesin e prokurimit kanë

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 14 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka përfunduar procesin e numërimit të votave të kandidatëve për deputetë në Qendrat Komunale të Numërimit në komunën e Hanit të Elezit, Shtërpçës, Parteshit dhe Ranillugut. “Ka përfunduar procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) në komunat: Hani i Elezit, Shtërpçë, Partesh dhe Ranillug”, ka njoftuar KQZ-ja. Më tutje, KQZ-ja ka bërë me dje

se deri më 13 shkurt janë numëruar 386 vendvotime. “Në përgjithësi, nga të dhënat që kemi pranuar nga Qendrat Komunale të Numërimit në 26 komuna (4 prej të cilave filluan numërimin më 11 shkurt, 14 tjera pasditën e 12 shkurtit dhe 8 më 13 shkurt) deri më 13 shkurt janë numëruar 386 vendvotime”, ka njoftuar KQZ-ja. E kur janë numëruar mbi 99 për qind e votave vetëm për subjektet politike, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, i ka fituar 40.84 për qind të votave, sipas KQZ-së. Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, i ka fituar 22.05 për qind të votave,

Çitaku reagon ashpër ndaj Speciales: Sa duhet të rëndohet shëndeti i babait të Thaçit që t'ia lejojnë vizitën?



PRISHTINË, 14 SHKURT - Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka reagu pas publikimit të vendimit ku ish-presidentit Hashim Thaçi i është refuzuar kërkesa nga Gjykata Speciale që ta vizitojë babanë, i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore.

Çitaku ka thënë se një vendim i tillë as nuk është i drejtë dhe as njerëzor. Ajo e ka pyetur Gjykatën Speciale se a ka matës për dhimbjen e një prindi i cili pret ta shohë të birin para se t'i mbyllë sytë.

"Gjykata Speciale paska deklaruar që nuk ka arsye të mjaftueshme për ta liru për vizitë presidentin Thaçi. Se baca Haxhi, i shtrirë në shtrat, duke luftuar me dhimbjen dhe moshën, nuk qenka 'mjaftueshëm' i sëmurë. Sa më shumë duhet të vuajë një baba që t'i njihet dhimbja? Sa duhet të rëndohet shëndeti i tij që ta quajnë 'boll'? A ka një matës për dhimbjen e prindit që pret të shohë të birin para se të mbyllë sytë? Kjo nuk është drejtësi! Kjo nuk është njerëzi! Një zemër e lodhur pret të rrahë edhe një herë me shpresën e një përqaftimi të fundit. Por edhe këtë të drejtë ia mohojnë. Historia do të gjykojë edhe këto padrejtësi",

ka shkruar Çitaku në "Facebook". Gjykata Speciale ka publikuar vendimin absurd me të cilin është refuzuar kërkesa që Hashim Thaçi ta vizitojë babanë në gjendje të rëndë shëndetësore. Specialja në vendim ka theksuar se nuk ka arsye të forta që Thaçi ta vizitojë babanë e tij.

Në vendimin e Speciales është thënë se gjendja shëndetësore e babait të Thaçit nuk është aq e rënduar. "Paneli nuk është i bindur se gjendja aktuale mjekësore e zotit Haxhi Thaçi përbën rrethana të forta sipas kuptimit të Rregullit 56(3). Konkretisht, Paneli vëren se, megjithëse zoti Haxhi Thaçi ka qenë i shtruar në spital nga [REDAKTUAR] janar 2025 dhe është ri-pranuar në Departamentin e Emergjencës më [REDAKTUAR] janar 2025, gjendja e tij duket se është stabilizuar që kur ai është larguar nga spitali. Ndërsa mbrojtja e Thaçit thekson rekomandimin në raportin mjekësor që thotë se zoti Haxhi Thaçi duhet të jetë [REDAKTUAR], nuk ka asnjë informacion në Kërkesë që sugjeron se zoti Haxhi Thaçi ka pasur nevojë për ri-shtrimin në spital ose që tregon ndonjë shenjë të degradimit të gjendjes së tij. Paneli vëren se zoti Haxhi

Thaçi është në moshë të shtyrë dhe ka shqetësime shëndetësore, por, siç është theksuar, nuk ka asnjë informacion në Kërkesë që tregon se sëmundja e tij është aktualisht serioze", është thënë në vendim.

Gjykata Speciale ka pretenduar se Thaçi përbën rrezik për dëshmitarët, andaj duhen kushte strikte për ta realizuar një vizitë të tillë. "Duke kujtuar se lëshimi për arsye humanitare të fuqishme duhet të balancohet me faktorë të tjerë të rëndësishëm, Paneli gjithashtu merr parasysh: (i) ekzistencën e një klime të vazhdueshme intimidimi ndaj dëshmitarëve dhe ndërhyrje në procedurat penale kundër ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kosovë; (ii) faktin që Paneli ka modifikuar kushtet e ndalimit të zotit Thaçi pasi ka dukur se ai ka dhënë informacione për vizitorët që

nuk gëzonin privilegje, të cilat janë nxjerrë gjatë dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtur; dhe (iii) faktin që zoti Thaçi është ngarkuar - përveç akuzave në këto procedura - për vepra penale kundër administratës së drejtësisë dhe administratës publike dhe vepra penale kundër rendit publik për shkak të dyshimit për zbardhjen e informacionit sekret që i është komunikuar gjatë këtij gjykimi dhe, së bashku me të tjerët, për koordinimin për të ushtruar ndikim të paligjshëm mbi dëshmitarët e Prokurorisë në këtë çështje", është thënë në vendim.

Në fund të vendimit është thënë se gjendja mjekësore e babit të Thaçit nuk është arsye e fortë, por ia ka mundur disa videolidhje më të shpeshta. "Për këto arsye, Paneli vlerëson se, në balancë dhe në rrethanat aktuale, gjendja mjekësore e zotit Haxhi Thaçi nuk përbën

arsye të forta humanitare që justifikojnë lirimin e tij të përkohshëm për një vizitë shëndetësore. Përfundimisht, Paneli vëren se Zyra e Regjistrimit ka përmendur se ekzistojnë mjete alternative për të mundësuar që zoti Thaçi të mbajë kontakte të ngushta me prindërit e tij. Prandaj, dhe duke marrë parasysh rëndësinë e kontakteve me anëtarët e ngushtë të familjes dhe në dritën e rrethanave mjekësore të përmendura më lart, Paneli urdhëron regjistrarin që: (i) të mundësojë mundësinë e [REDAKTUAR] për muajin shkurt 2025; dhe (ii) të lejojë [REDAKTUAR] vizita shtesë me video, me [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] shkurt 2025", është thënë në vendimin e Speciales.

Për refuzimin e vizitës kishte treguar avokati i Thaçit, Luka Misetiq.



penguar blerjen e pajisjeve teknike për qendrat e votimit, përgatitjen e materialeve për edukimin e votuesve, si dhe operacionet logjistike për shpërndarjen e materialeve zgjedhore", është thënë në deklaratën e misionit të BE-së të lëshuar më 11 shkurt. Kryesuesi i një qendre të votimit në Prishtinë - i cili nuk ka dashur të identifikohet - ia ka përshkruar "Radios Evropa e Lirë" procesin e numërimit të votave për deputetë si kaotik, duke përmendur edhe

problemin e trajnimit joadekuat të stafit, "me nga 500 persona në një sallë, pa mikrofon, vetëm një ditë para zgjedhjeve".

Deklaratat e tij janë në linjë me reagimin e misionit të BE-së: "Kualiteti i sesioneve trajnuese të stafit në qendrat e votimit ka dalluar. Ndonëse shumica e tyre kanë qenë informative dhe interaktive, në disa raste, çështjet kyçe, sikurse rregullorja e re për votimin e asistuar, rolet e komisionarëve dhe procedurat e numërimit,

nuk janë adresuar në mënyrë të njëtrajtshme, duke rezultuar me zbatim jokonsistent të tyre në ditën e zgjedhjeve".

Hetimet e prokurorisë

Ish-zyrtarë të KQZ-së, me të cilët ka biseduar "Radio Evropa e Lirë", kanë shprehur keqardhje për këto lëshime në proces, dhe kanë fajësuar udhëheqjen e institucionit për këtë situatë. Sipas tyre, zyrtarët e rinj sikur e kanë pasur një tendencë që të eliminojnë çdo

praktikë të mëparshme, pavarësisht se a ka funksionuar.

Disa kanë folur me tone kritike edhe për mungesën e kryetarit të KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, në deklaratime për medie.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka konfirmuar se ka kërkuar nga KQZ-ja marrjen e informatave të nevojshme për të vërtetuar nëse ka elementë të kryerjes së ndonjë vepre penale.

Vetë KQZ-ja ka thënë më 12 shkurt se i ka bërë thirrje

Prokurorisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera të sigurisë për ta sqaruar situatën dhe për të ofruar mbështetje teknike, teksa ka siguruar se, pavarësisht gjithë kësaj situatë, integriteti i votës nuk është cenuar dhe se rezultatet do të jenë të sakta. Edhe ish-zyrtarë të KQZ-së kanë thënë se njëmend është vështirë të manipulohet vota, por e keqja e gjithë kësaj është humbja e besimit të qytetarëve në procesin zgjedhor.

ECURIA HISTORIKE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

Konferenca e Bujanit mori këtë vendim: miratohet e drejta e vetëvendosjes së popullit: bashkimi i Kosovës me Shqipërinë! Shqiptarët e pritën krahëhapur këtë vendim, por e kundërshtoi udhëheqja e partisë komuniste jugosllave



Hasan MUJAJ

Ecuria historike e Kosovës shtet. Ajo ishte e gjatë. Shumë e gjatë. Rreth njëshekullore. Shprehur me stilin metaforik, ishte ecuri përplot kreshta, shkëmbinj e rrëpira. Por, me vullnetin granit për të drejtat kombëtare, për themelimin e shtetit të Kosovës, qe ecuri e tejkalueshme: me flijimet heroike lapidarë të përherëshëm dritëdhënës të astritëve dhe feniksëve lavdimëdhën timer të UÇK-së, në bashkërendim me NATO-n, ecuria e gjatë e lirisë dhe e pavarësisë, u trupëzua. Pretendimet e politikës serbe për të rrëmbyer territore shqiptare janë të hershme, sidomos nga platforma politike e Ilija Garashaninit, e quajtur "Naçertanija" dhe në vijimësi gjatë historisë, edhe sot! Kjo platformë u pasua edhe nga projektet e tjera antishqiptare të politikanëve e shkrimtarëve serbë që kishin një qëllim: për t'i ndjekur me detyrim shqiptarët nga trojet e tyre etnike sipas parashikimit të Vasa Çubriloviqit dhe Konventës jugosllave - turke të vitit 1938 ngjashëm me etnocidin e viteve 1877- 1878 që u bë nga Merdarja deri në Nish për t'i kolonizuar këto krahina me serbë.

Politika e gjenocidit serb ndaj shqiptarëve do të veprojë edhe me projektet e I. Andriqit, D. Çosiqit, S. Milosheviqit për të vazhduar edhe sot me në krye A. Vuçiqin. Do theksuar fakti se, me gjithë krimet që Beogradi zyrtar i bënte mbi shqiptarët, sidomos në Kosovë si: burgosje të qytetarëve të pafajshëm, vrasje, izolime (është i njohur izolimi i dhunshëm i intelektualëve të lartë shqiptarë në Kosovë) etj., rezistenca shqiptare për kultivimin e identitetit kombëtar, nuk shpërbëhej, nuk ndalej, porse sa vinte e zgjerohej dhe përforcohej si në mërgatën

shqiptare, ashtu edhe në etninë e saj.

Ajo (qëndresa shqiptare) vepronte e shënonte arritje të reja organizimi dhe konsolidimi për ta mbrojtur me penë e me armë tërësinë territoriale jo vetëm të Kosovës, por edhe të krahinave të tjera shqiptare si: Hoti, Gruda, Vranina, Plava, Gucia, Zhanica etj., të cilat (krahina), siç i përshkruan edhe Gjergj Fishta në kryeveprën "Lahuta e Malsisë", kishte pretendim t'i aneksonte Mali i Zi me mbështetjen e Serbisë.

Për një strategji organizimi e veprimi sa më efikas të mbrojtjes së territoreve, shqiptarët formuan organizatën politike e quajtur "Balli Kombëtar" në vitin 1939, kryetar i së cilës u zgjodh gjeniu i kombit dhe kryetari i Kongresit të Manastirit, Mit-hat Abdyl Frashëri. Më pas u quajt edhe me emërtimin: "Lëvizja Kombëtare e Rezistencës" me një veprimtari të pasur kombëtare e antikomuniste dhe u shtri në Tiranë, Prishtinë e Tetovë për ta zgjeruar veprimtarinë gjithëkombëtare në tërë etninë shqiptare. Drejtuesit e saj, në disa qytete të Kosovës, u ndoqën dhe u burgosën nga diktatura komuniste serbe.

Lidhja e Dytë e Prizrenit

Ishte vijuese e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e vitit 1878, gjithnjë në funksion të zhvillimit të veprimtarisë kombëtare për të drejtat nacionale dhe për

Shqipërinë etnike. Kuvendi për themelimin e kësaj Lidhjeje u mbledh në Prizren në shtator të vitit 1943 në të cilin morën pjesë delegatë që përfaqësonin qytete dhe krahina të ndryshme shqiptare. Ai mori vendim për formimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, së cilës i vihej detyrë parësore të organizonte mbrojtjen e trojeve të etnisë shqiptare. Kryetar i Lidhjes u zgjodh Rexhep Mitrovica dhe më pas, në janar të vitit 1944, Bedri Pejani. Megjithatë, udhëheqja jugosllave asokohe shkeli të drejtën universale të vullnetit të popujve për deklarimin e lirë dhe, në mbledhjen e dytë të AVNOJ- it, mbajtur në Jajcë më 29-30 nëntor 1943, mori vendim që Kosova dhe krahinat e tjera shqiptare të mbesin në përbërjen e RSFJ-së.

Konferenca e Bujanit

Si reagim kundërvënës ndaj vendimit të Jajcës, rrodhi Konferenca e Bujanit, mbajtur më 31. 12 dhe 1 e 2 janar 1944; të pranishëm katërdhjetë e tre delegatë shqiptarë dhe gjashtë serbë; kryetar i Konferencës u zgjodh Mehmet Hoxha. Pas kritikave ndaj qëndrimit të Jajcës, Konferenca e Bujanit mori këtë vendim: miratohet e drejta e vetëvendosjes së popullit: bashkimi i Kosovës me Shqipërinë! Shqiptarët e pritën krahëhapur këtë vendim; por, e kundërshtoi udhëheqja e partisë komuniste jugosllave. Rezoluta e Bujanit u nënshkrua për bashkimin e shqiptarëve! Në këtë ecuri politike ndodhi një veprim antonimik e hipokrit nga kryetari jugosllav - J. B. Tito. Ai, për gazetën amerikane "Associated Press", kishte deklaruar se Kosova dhe territoret e tjera shqiptare "do t'i kthehen Shqipërisë"; këtë qëndrim ia kishte shprehur

edhe kryetarin të Shqipërisë - Enver Hoxha. Nga ana tjetër lideri jugosllav tumir kërkesën e gjeneralëve serbë sipas së cilës në Kosovë u vu administrimi i dhunshëm ushtarak më 8 shkurt të vitit 1945 me komandë në Prizren.

Do mbajtur parasysh fakti se, gjatë këtij administrimi, u vranë me mijëra shqiptarë. Vetëm gjatë muajve mars-prill të vitit 1945, në qytetin shqiptar - Tivar, u vranë rreth katër mijë shqiptarë nga ushtarakët serbë! Dhe, vazhdon politika diskriminuese serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ajo, gjatë viteve të 50-ta, thelloi dhe zgjeroi përdorimin e dhunës dhe të burgosjeve të shqiptarëve; për ta ndjekur këtë politikë, ajo shpiku "arsyetimin" e mbledhjes së armëve dhe të flamurit kombëtar shqiptar. Me gjithë masat represive të politikës së punëve të brendshme, të UDB-së që drejtohej nga ministri antishqiptar A. Rankoviqi, lëvizja shqiptare nuk ndalej së vepruari për zhvillimin e të drejtave kombëtare. Rënia e Rankoviqit nga pushteti në Plenumin e Brionëve në korrik të vitit 1966, shënoi një kthesë të vogël në favorin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Si frymëzim i përforcimit dhe i labërgimit të lëvizjes shqiptare ishte edhe programi politik-kombëtar i shkrimtarit dhe i atdhetarit shkëmb i pathyer, i Adem Demaçit, i cili, me gjithë masat e dhunshme që ndërmerreshin ndaj tij nga UDB- ja serbe, përpara gjykatave të Serbisë, e thoshte të vërtetën për krimet që pushteti serb i bënte ndesh shqiptarëve në Jugosllavinë e atëherëshme.

Veprimtaria kombëtare, heroike e flijuese e Adem Demaçit për të drejtat e shqiptarëve u bë inspirim e burim i vrullshëm

jehues për ta ndjekur rrugëtimin e tij. Kërkesat e tij publike për zhvillimin e arsimit, të shkencës, të kulturës etj. në gjuhën shqipe, për simbolet kombëtare etj. krijonin dhe ndikonin në trajtimin dhe në zhvillimin e motivit kombëtar që aq shumë i duhej Kosovës asokohe. Për kërkesat e kësaj, A. Demaçi njëzet e tetë vjet i kaloi në burgjet e Serbisë si i burgosur politik! E pabesueshme, por e vërtetë. Pasi diktati politik komunist i kohës nuk lejonte publikimin e shkrimeve të veprimtarisë patriotike të A. Demaçit, u gjet varianti pragmatik që ajo veprimtari me jehonë të madhe kombëtare të shprehej përmes këngësh që këndoheshin në oda e manifestime të ndryshme kulturore nga rapsodët popullore. Edhe kjo mënyrë afirmative e kontributit të këtij vigani kombëtar do parë si shtysë nxitëse e kapital motivues i lëvizjes shqiptare të Kosovës për të drejtat kombëtare.

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës

Konsulta e Prishtinës ishte njëri nga përbërësit më të rëndësishëm të lëvizjes kombëtare gjithëshqiptare. Ajo shënoi një arritje të madhe jo vetëm në pikëpamjen e zhvillimit shkencor të gjuhës shqipe, por edhe në aspektin e integritetit dhe të përafritimit të kombit shqiptar, të ndarë me detyrim nga politika serbe në disa shtete.

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e mbajtur në muajin prill të vitit 1968, në të cilën morën pjesë studiuesit më të spikatur të shkencave albanologjike, historike, filozofike e të tjera dhe përfaqësues institucionesh të ndryshme si: të arsimit, të kulturës, të medieve etj., ndoqi parimin "Një komb - një gjuhë letrare" dhe miratoi Projektin e Drejtshkrimin të gjuhëtarëve specialistë të Tiranës.

Reagimet e Beogradit zyrtar e kundërshtuan mbajtjen e Konsultës madje sendërtimin e saj e quajtën "homogjenizim kombëtar", sepse, Beogradi thoshte: "gjuha e shqiptarëve të Kosovës quhet shiptarski jezik, në Shqipëri quhet albanski jezik"; implikatura e këtyre shprehjeve nënkupton se shqiptarët duhet të jenë të ndarë edhe nga gjuha, ngase njësimi i gjuhës do të thotë njësimi i kombit. Kundërshtitë e politikës serbe qenë aq të mëdha, sa që u kërkua nga





udhëheqësit e Kosovës që të mos lejohej mbajtja e Konsultës! Kundërshtimi i Beogradit nuk u pranua nga politika shqiptare e Kosovës. Veprim shumë i drejtë. Madje udhëheqja politike e Kosovës i priti zyrtarisht organizuesit e Konsultës dhe i përgëzoi për këtë arritje të madhe jo vetëm shkencore, por edhe gjithëkombëtare Konsulta e Prishtinës, me vendimin e marrë, u bë pararendëse e Kongresit të Drejtshkimit të Gjuhës Shqipe që u mbajt në Tiranë në nëntor të vitit 1972.

Për rëndësinë e Konsultës, linguisti prominent, akademik Eqrem Çabej shkroi: "Gjuha standarde, unike për tërë kombin, nuk ka vetëm rëndësi shkencore, për zhvillimin e saj shkencor, porse ka edhe rëndësi kulturore, politike dhe kombëtare."

Demonstratat e studentëve të vitit 1968 shënuan një vazhdimësi më të gjerë publike të lëvizjes kombëtare. Ato shprehën revoltën përkitazi me gjendjen e vështirë dhe të padurueshme të rrethanave politike dhe ekonomike të shqiptarëve, sidomos arsimore e kulturore; ato kërkuan përdorimin e lirë të simbolit kombëtar: të Flamurit, kërkuan themelimin e Universitetit të Prishtinës, statusin e Kosovës Republikë etj.

Këto demonstrata bënë një hap të madh përparimi sa u takon të drejtave kombëtare të shqiptarëve të Kosovës: u lejua përdorimi i Flamurit dhe, diç më vonë, u themelua Universiteti i Prishtinës, më 15 shkurt 1970.

Burimi më i madh i diturisë, Universiteti i Prishtinës, u bë vatra më ndriçuese nga po ngriheshin lart, lart shkëndijat shkencore, arsimore, kulturore e

kombëtare. Bashkëpunimi gjithnjë e më i ndërlidhur me Universitetin e Tiranës solli përafrime shkencore dhe gjithëkombëtare. Në degët e shkencave të albanistikës dhe të historisë u hapën edhe studimet pasuniversitare në të cilat ligjërtonin edhe profesorët e Universitetit të Tiranës. Vitet '70 shquhen edhe për disa arritje tejet të rëndësishme politike dhe shkencore të Kosovës; në vitin 1974 u miratua Kushtetuta e re jugosllave sipas së cilës avancohej statusi politik i krahinave me disa kompetenca në Federatën jugosllave. Për këtë ndryshim reagoi politika e Serbisë me pamfletin politik të quajtur "Libri i kaltër" me të cilin u kërkuar që në Kosovë të mbizotërojë juridiksioni serb me reduktimin e kompetencave kushtetuese, sidomos në resorët: bashkëpunimi ndërkombëtar, punët e brendshme dhe arsimi.

Rezultate relevante e risimtare u zhvilluan edhe në veprimtarinë shkencore gjatë këtyre viteve: u themelua Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në vitin 1974 në kuadër të Fakultetit (atëherë) Filozofik (më vonë Fakulteti i Filologjisë), i cili vazhdon veprimtarinë edhe sot dhe zgjoi interesimin e madh dhe kërshërinë për studimet albanologjike në përmasat botërore.

Një vit më pas (më 10. 12. 1975) në Prishtinë u themelua institucioni më i lartë shkencor i një shteti: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës që ishte dëshmi se Kosova, edhe asokohe, kishte potencial shkencor, studiues elitare dijes të ndryshme dhe me zulumë ndërkombëtare. Ndonëse me pengesa të mëdha politike të diktatit të Beogradit,

institucionet arsimore e shkencore të Kosovës vazhdonin rrugëtimin orientues për të ravigëzuar hulli të reja për të trupëzuar qëllimin kombëtar të lëvizjes shqiptare.

Nga ky këndkudrim do parë shënimi dhe ndriçimi shkencor i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për të cilën u mbajt Konferenca Shkencore në qershor të vitit 1978, me rastin e njëqindvjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Kjo Konferencë Shkencore bëri jehonë të madhe ndërkombëtare; ajo ringjalli programin gjithëkombëtar të Lidhjes, i cili (program) kishte qëllimin kryesor të formohej pavarësia e Shqipërisë sipas kufijve natyrorë të shtrirjes së saj etnike. Lëvizja shqiptare nuk ndalej së vepruari; ajo përgatitej për ndërhyrjet e reja.

Në marsin e vitit 1981 filluan demonstratat masive dhe madhështore të studentëve të Universitetit të Prishtinës, të cilat u bënë gjithëpopullore në tërë Kosovën; ato reagonin me të drejtë kundër shfrytëzimit të pasurive natyrore të Kosovës nga Serbia me brohoritjen kryesore: "Trepça punon, Beogradi ndërton". Natyrisht kërkonin të ngrihej statusi politik e juridik i Kosovës në Republikë.

Kundër demonstruesve paqësorë filluan masat brutale: vrasjet, arrestimet, burgosjet etj. nga policia dhe ushtria serbe e jugosllave. U bënë përjashtimet nga puna dhe nga pozitat drejtuese të Universitetit etj. Posa erdhi në pushtet, Millosheviqi shfuqizoi me diktat politik autonominë që i ishte dhënë Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974 dhe mori masat rigoroze ndaj shqiptarëve si: përjashtimin nga puna të të gjithë shqiptarëve, mbylljen e të gjitha institucioneve të arsimit, mbylljen e medieve në gjuhën

shqipe etj. Me këto veprime edhe në Kosovë synohej të zbatohet etnocidi ndaj shqiptarëve dhe të bëhej kolonizimi i madh me popullatën serbe ashtu sikundër ishte bërë me krahinën e Toplicës njëqind e dyzet e pesë vjet më parë.

Mirëpo, shqiptarët nuk u dorëzuan as gjatë kësaj gjendjeje terrorizuese që e bënte politika e Beogradit ndaj Kosovës. Ata imitonin një "pushtet paralel" dhe, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, kërkonin që çështja e Kosovës të zgjidhej me paqe e dialog. Por, Beogradi nuk e deshi dialogun, i bindur se Kosovën do ta mbante përherë me dhunë e diktaturë nën diktatin politik të Serbisë. Shqiptarët u përcaktuan për dy politika: fillimisht për politikën e rezistencës paqësore, por, në heshtje, edhe për përgatitjen e luftës së armatosur. Strategjia e politikës me dialog i duhej Kosovës për ta yshtur faktorin ndërkombëtar se Prishtina ishte për zgjidhje paqeje. Mirëpo, pasi u dëshmuar se Beogradi nuk pranonte marrëveshje dialogu, Kosovës iu imponua lufta.

Lufta e armatosur

Milosheviqi urdhëroi luftën pushtuese ndaj Kosovës; për këtë qëllim vuri në përdorim forca të mëdha ushtarake, policore e paramilitare për të kryer krime e masakra ndaj popullatës së paarmatosur shqiptare, të cilat befasuan botën demokratike.

Për ta mbrojtur popullatën civile nga terrori i forcave të armatosura serbe, doli UÇK-ja, e cila, ndonëse me armatim modest, por me moral të lartë, e betuar përpara Flamurit Kombëtar për t'u flijuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës,

jo vetëm që fitoi disa beteja në përballjen me forcat ushtarake e policore serbe shumëfish më të mëdha në numër dhe me armatim modern, por krijoi panik të paparë te njësitë e forcave të armatosura serbe. Si shembull konkret, flet **Beteja e Loxhës** në të cilën armata serbe pësoi disfatë të madhe nga UÇK-ja dhe, pasi la disa ushtarë të vrarë, u detyrua të ikte me vrap drejt kazermave ushtarake të Pejës.

Mediet e Beogradit "e arsyetuan" këtë humbje me konstatimin gënjeshtar se "në fshatin Loxhë afër Pejës kanë hyrë qindra terroristë".

UÇK-ja zhvilloi luftë mbrojtëse, të imponuar e të drejtë. Ajo nuk bëri masakra mbi popullatën civile serbe siç bënë ushtria, policia dhe paramilitarët serbë p. sh. janë të njohura edhe në nivelin ndërkombëtar masakrat në: Prekaz, Reçak, Mejë, Qyshk, Lybeniq, Krushë e Vogël, Likoshan e shumë të tjera; UÇK-ja nuk vrau fëmijë, gra e të moshuar si ushtria e policia serbe; ajo nuk dhunoi e nuk dogji vendbanime të popullatës serbe siç dogjën shtëpitë dhe banorët shqiptarë ushtria dhe policia serbe e krime të tjera, të cilat befasuan politikën e diplomacinë ndërkombëtare.

Pasi kryetari serb refuzoi ta nënshkruante marrëveshjen paqësore të Rambujesë si dhe kërkesën e drejtpërdrejtë të emisarit të autorizuar amerikan- Riçard Hollbruk, pasoi ndërhyrja e sulmeve të NATO-s që, në aleancë me UÇK-në, e detyruan Beogradin ta nënshkruante kapitullimin.

Milosheviqi e humbi luftën e armatosur me të cilën mendonte për ta rrëmbyer Kosovën, prandaj Vuçiçi duhet ta dijë se s' ka çka të kërkojë në Kosovë.

Lavdi e përhershme të gjithë dëshmorëve të kombit!

UP-ja feston 55-vjetorin: Nderohet e kaluara dhe e ardhmja

PRISHTINË, 14 SHKURT - Universiteti i Prishtinës të premtën ka festuar 55-vjetorin e themelimit me një varg aktivitete festive. Përvjetori i 55-të ka nisur në Sallën e Senatit të Rektoratit, me nderimin që iu bë profesorëve që përfundojnë mësimdhënien aktive në Universitetin e Prishtinës. Atyre iu dhanë mirënjohje për kontributin jetësor për edukimin e

brezave të rinj. Pastaj ceremonia solemne është mbajtur në amfiteatrin e Bibliotekës Qendrore Universitare, ku është shfaqur një dokumentar për Universitetin e Prishtinës. Të pranishmëve u është drejtuar me një fjalë rasti rektori Arben Hajrullahu. Dy video-mesazhe në përvjetorin e UP-së erdhën edhe nga Qendra

Interdisiplinare për Siguri, Besueshmëri dhe Mirëbesim (SnT) në Universitetin e Luksemburgut dhe Kolegji Akademik Gordon në Haifa të Izraelit.

Në këtë ditë të shënuar janë nderuar edhe studentët më të mirë të Universitetit të Prishtinës. 55-vjetori i UP-së është përcjell edhe me pika artistike të përgatitura nga studentët dhe profesorët e Fakultetit të Arteve.



AKP-ja i ndryshon rregullat e shitjes

PRISHTINË, 14 SHKURT - Bordi i drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e fundit të mbajtur i ka ndryshuar aktet nënligjore lidhur me shitjet me tender publik. Ndryshimet janë bërë me qëllim të rritjes së transparencës dhe efikasitetit në procesin e tenderimit dhe shitjes së aseteve. Sipas rregullore të ndryshuara, me rastin e shpalljes së shitjeve (ShAL) të ardhshme, në dokumentet e tenderit dhe në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë, do të publikohen edhe dy informata shtesë për asetet në shitje: 1. Kategoria e aseteve të shpallura për shitje; dhe 2. Çmimi minimal i shitjes së aseteve. "Publikimi i kategorisë së aseteve të

shpallura për shitje: Gjatë publikimit të valëve të reja të shitjes së aseteve, për çdo aset / pronë që shitet do të përfshihet kategoria e asetit. Në dokumentin informues do të shpaloset kategoria: i) pronë bujqësore, ii) pronë rezidenciale, iii) pronë komerciale, apo iv) pronë industriale. Kriteret për kategorizimin e pronave janë: i) shfrytëzimi aktual, dhe ii) shfrytëzimi potencial i pronës në të ardhmen. Kategorizimi i aseteve do të shërbejë vetëm për qëllime të përcaktimit të çmimit minimal për shitjen e tyre dhe nuk do të ketë asnjë efekt tjetër në ndryshimin e kategorisë së aseteve në regjistrat e kadastrave", ka njoftuar ATK-ja, duke njoftuar



edhe për publikimin e çmimit minimal i shitjes së aseteve. "Ndryshimi i dytë ka të bëjë me atë që për çdo aset/pronë që shitet do të shpaloset për publikim informata për çmimin minimal të shitjes. Çmimi minimal nënkupton vlerën më të ulët të përcaktuar

nga AKP për shitjen e një aseti. Ky çmim caktohet për të siguruar që një aset nuk shitet nën vlerën e arsyeshme. Nëse nuk ka oferta mbi këtë çmim, procesi i shitjes do të përsëritet në valën e ardhshme të shitjes. Për objekte që tenderohen, çmimi orientues prezantohet me euro/m² (euro për metër), ndërsa për toka që tenderohen çmimi orientues prezantohet me euro/ari (euro për ari)", theksohet në njoftimin e ATK-së.

ATK-ja ka njoftuar se si çmim minimal i shitjes së aseteve do të merret vlera e pronave (sipas zonave dhe niveleve të vlerave) e përcaktuar nga Ministria e Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë, për qëllime të tatimit në pronë. "Nëse ky

çmim rezulton çmim shumë i ulët, ose ku nuk ka fare vlerësim të Ministrisë së Financave, atëherë çmimi minimal do të caktohet me metodën e përlogaritjes së çmimit mesatar të shitjeve të realizuara nga AKP brenda tre (3) viteve të fundit. "Gjithashtu edhe vlera e depozitave do të përcaktohet sipas çmimeve minimal dhe atë në dy kategori: për asetet që kanë çmimin orientues deri në 100,000 euro depozita do të jetë 10 % e vlerës; për asetet që kanë çmimin orientues mbi 100,000 euro depoziti do të jetë 5 % e vlerës. Ndërkaq, për asetet e luajtshme depoziti përcaktohet nga Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operativës", ka njoftuar ATK-ja.

Në Maqedoninë e Veriut diskutohet për modelin e mbështetjes për sektorin privat përmes partneritetit publiko-privat

SHKUP, 14 SHKURT - Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Maqedoninë e Veriut, Izet Mexhiti, ka pritur një delegacion nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) për Maqedoninë e Veriut, të udhëhequr nga drejtori rajonal për Ballkanin Perëndimor, Nikolas Markier, i shoqëruar nga përgjegjësi i IFC-së për Maqedoninë dhe Kosovën, Visar Perani, përgjegjësi për investime në sektorin e energjisë për Ballkanin Perëndimor, Milica Sredanović dhe Vadim Sherbakov, përgjegjës i



Investimeve në Sektorin e Energjisë për Maqedoninë e Veriut. Në takimin e punës, IFC paraqiti modelin për

mbështetjen e sektorit privat përmes partneritetit publiko-privat, si dhe bashkëpunimin potencial afatgjatë dhe mundësitë për mbështetjen e

zhvillimit ekonomik të Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në zbatimin e agjendës së gjelbër si një nga prioritetet më të larta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ministri Mexhiti i njoftoi përfaqësuesit e IFC-së për prioritetet e qeverisë dhe aktivitetet e ndërmarra në këtë drejtim, duke vënë në pah ndotjen e ajrit dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në zonat urbane si prioritet kyç.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut, tha Mexhiti, po fokusohet në identifikimin e shkaqeve të ndotjes, jo të pasojave. Mexhiti informoi për

mbështetjen e deritanishme të BE-së dhe Bankës Botërore në këtë fushë, por theksoi se ka hapësirë për realizimin e një partneriteti publiko-privat në një fazë të mëvonshme. "Duke marrë parasysh se shkaktarët kryesorë të ndotjes janë ngrohja e amvisërive dhe ndotja nga trafiku, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut po bën përpjekje të mëdha për realizimin e projektit të gazifikimit, si një nga zgjidhjet kryesore, i cili synon që qytetarët të përdorin metoda ngrohëse miqësore me mjedisin, të cilat do të kontribuojnë në uljen e ndotjes për 50-70 për qind", tha Mexhiti.

Më 17 shkurt do të parakalojnë FSK-ja dhe Policia e Kosovës

PRISHTINË, 14 SHKURT - Me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt, në orën 12:00, do të zhvillohet parakalimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës në sheshin "George Bush" në Prishtinë. Ministria e Punëve të

Brendshme ka njoftuar se qytetarët dhe përfaqësuesit e medieve janë të ftuar ta ndjekin manifestimin qendror dedikuar përvjetorit të 17-të të Pavarësisë së Republikës së Kosovës që mbahet në përkujdesjen e presidentes dhe kryeministrit të Republikës së Kosovës. "Kjo

ngjarje do të shërbejë si një nderim për të arriturat e vendit tonë dhe një mundësi për të gjithë qytetarët që të bashkohen në një atmosferë feste, për ta shfaqur krenarinë kombëtare dhe për t'i kujtuar sakrificat e shumta në rrugën drejt lirisë e pavarësisë", thuhet në njoftim.



Shpërngulja e shqiptarëve në vitet 1912-'39 dhe reagimi i shtetit shqiptar



Nga: Qerim LITA

Me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, tërheqjen e Perandorisë Osmane dhe pushtimin e tokave shqiptare nga aleanca ortodokse ballkanike, rifilloi procesi i shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga trojet e tyre etnike, për në Republikën e Turqisë. Dokumentet e zbuluara kohët e fundit, hedhin dritë se brenda vitit 1912-'13, ushtritë pushtuese serbo-malazeze dhe greke, dëbuan me dhunë mbi 200 mijë shqiptarë; pjesa dërrmuese e tyre u vendosën në Stamboll, Anadoll dhe në vise të tjera të Turqisë. Ndërsa, sipas një llogaritjeje të bërë nga Legata Shqiptare e Ankarasë, në vitin 1928, në Turqi, gjendeshin 27-30 mijë familje shqiptare, të shpërngulura nga Kosova, trevat Lindore dhe Çamëria, duke përfshirë edhe ata shqiptarë që kishin emigruar pas vitit 1913.

Tërë ajo politikë e dhunshme që zbatohet asaj kohe nga pushtuesit serbo-malazezë, kishte një qëllim të vetëm: Të ndryshohet me çdo çmim karakteri etnik në krahinat ku banojnë shqiptarët. Si shembull po e përmendim ngjarjen tejet të shëmtuar që ndodhi në pranverë të vitit 1913 në Kërçovë, kur çetnikët serbë, pasi e kishin rrethuar tërë qytetin, futën nëpër shtëpitë shqiptare, ku i marrin

të gjithë meshkujt dhe i dërgojnë për t'i ekzekutuar në vende të veçanta: një pjesë prej tyre në vendin e quajtur "Çiflik", një pjesë tjetër në "Biçincë-Jurie" dhe të tjerët në shkollën fillore në qendër të qytetit. Pasi i grumbullonin në këto tre vende, të gjithë meshkujt shqiptarë të qytetit, nga ana e dy kriminelëve të njohur komito-çetnikë të asaj ane, vojvoda Mikail Brodi dhe vojvoda Stanka Dimitrieviq, bëhej ndarja se cili prej tyre duhej vrrarë me therje, cili me pushkë e cili me dru. Përveç se u vranë në mënyrën më mizore, atyre u qe plaçkitur e tërë pasuria.

Është me rëndësi të vihet në dukje fakti se pjesa më e madhe e të shpërngulurve gjatë viteve 1912-'13, jetonte në kushte të mjerueshme, sepse tërë pasuria e tyre e tundshme dhe e patundshme u ishte konfiskuar nga ana e pushtuesve sllavo-ortodoksë. Ndonëse ata dikur kishin qenë qytetarë dhe shtetas të Perandorisë Osmane, me krijimin e Republikës moderne të Turqisë (1923), pjesës dërrmuese të tyre iu mohojnë shtetësia turke, me çka atyre ua vështirësuan edhe më shumë kushtet e jetesës.

Në këto rrethana, shumë prej tyre dëshironin të ktheheshin në vendlindjet e tyre, ku i kishin lënë shtëpitë dhe pronat, mirëpo këtë nuk ua mundësonin autoritetet pushtuese të Beogradit, të

cilat u rekomandonin të akredituarave të tyre pranë Konsullatës së Stambollit, që gjatë dhënies së vizave hyrëse të kenë kujdes që "në mesin e tyre mund të ketë edhe të tillë të cilët dëshirojnë të futen në territorin tonë, me qëllim që të ngelin te ne".

Përveç kësaj, ata e filluan një fushatë të gjerë ushtarako-policore, goja për kapjen e të arratisurve, përkatësisht të anëtarëve të Lëvizjes Kaçake, të cilët konsideroheshin krahu luftarak i Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës (KMKK). Gazeta turke "TNIN" shkruante se autoritetet e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllavene (më tej MSKS), po zbatojnë një terror të paparë "ndaj popullsisë së atjeshme myslimane". Si rrjedhojë e këtij terrori, shumë familje shqiptare ishin detyruar t'i braktisnin vatrat e tyre, për t'u vendosur në vende më të sigurta, pjesa më e madhe për në Turqi, kurse një pjesë e vogël brenda shtetit shqiptar.

Ndërkohë, Legata e Serbo-Kroate-Sllavene në Sofje, më 3 qershor, me radiogram njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Beograd, për një vërshim të ri të popullsisë shqiptare myslimane nga Kosova dhe Maqedonia e sotme Veriore për në Turqi: "... Në kohët e fundit, myslimanët nga territori ynë po emigrojnë në Turqi. Një numër i caktuar i personave të tillë ngelin në territorin bullgar, për arsye se

pushtetarët turq në pikën kufitare i pengojnë të hynë brenda. Ata të shpërngulurit nga Serbia e Jugut (mendohet në Kosovën dhe Maqedoninë - Q. L.), tash nga Legata jonë në Sofje kërkojnë t'u lejoj kthimin në vendin tonë ...".

Kjo legatë e shihte si "të padrejtë" nga ana e autoriteteve turke, pamundësimin e popullsisë për të hyrë në Turqi, për arsye se siç theksohej në radiogram, "ata janë të shpërngulurit të cilët", para se ta lëshojnë vendin, "definitivisht janë deklaruar për qytetarë të Turqisë" dhe se, me këtë, "ata kanë të drejtë", përderisa kjo çështje nuk merr ndonjë zgjidhje përfundimtare. Po në këtë periudhë kohore, Qeveria greke shfrytëzoi Traktatin e Lozanës, të 30 janarit 1923, për të kryer një spastrim etnik të Çamërisë, sipas së cilit do të bëhej këmbimi i popullsisë turke e greke, në këto dy shtete.

Gjatë muajit qershor të vitit 1923, autoritetet greke dëbuan të gjithë banorët e 31 fshatrave shqiptare të Kosturit dhe Follorinës, të cilët arrinin në 33 mijë vetë. Ndërsa, në vjeshtën e atij viti, rritën presionin edhe ndaj Çamërisë. Shqiptarëve të kësaj krahine u ishte dhënë urdhër të lironin 75 për qind të shtëpive, në të cilat do të vendoseshin refugjatë grekë dhe u ishte bllokuar shitja e pasurive. Ndërkohë, më 7 nëntor të vitit 1923, i dërguari i Mbretërisë

Serbo-Kroate-Sllavene nga Stambolli, i raportonte Beogradit për takimin e tij me këshilltarin e lartë të MPJ-së të Turqisë, Mexhit Beut, i cili ia kishte përcjellë pakënaqësinë dhe brengën e madhe të qeverisë turke rreth "eksodit të vërtetë të popullsisë myslimane" nga Kosova në Turqi.

Sipas Mexhit Beut, një dukuri e tillë ishte tejet brengosëse për Qeverinë e Ankarasë e cila edhe ashtu "gjendet në rrethana të jashtëzakonshme me popullsinë e arratisur myslimane", e cila, sipas Marrëveshjes së Lozanës, të nënshkruar më 30 janar 1923 midis Turqisë dhe Greqisë, kishte filluar të shpërngulej për në Turqi. Kjo situatë e rëndë si duket ishte shkak kryesor që e detyroi Qeverinë shqiptare të iniciojë riatdhesimin e popullsisë së shpërngulur shqiptare nga Turqia, për në shtetin shqiptar. Për këtë arsye, një delegacion shqiptar i udhëhequr nga Eshref Frashëri, kryetar i Kuvendit, Xhafer Vila, sekretar i parë i Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe Nezir bej Leskoviku, më datë 15 tetor 1923, arriti në Stamboll. Atë e priti delegacioni turk, i udhëhequr nga deputeti Shukri Kaja.

Gjatë negociatave të cilat zgjatën më shumë se një muaj, u shqyrtuan dhe u debatuan në imtësi kërkesat e të dy palëve. Ndër kërkesat më të

rëndësishme të delegacionit shqiptar ishin: pranimi i Shqipërisë si shtet i pavarur; rregullimi i çështjes së shtetësisë e sidomos pranimi i shqiptarëve në Turqi si shtetas të Shqipërisë; konventë doganore e tregtare; konventë post-telegrafike; shumë shqiptarë të cilët kishin shërbyer në Turqi si nëpunës, qoftë në ushtri apo në administratë, të kenë të drejtën e pensionit, pasi këta nëpunës në arkë kishin lënë mjete për pension etj.

Palët negociuese, pasi ranë në ujdë për të gjitha çështjet, më 18 nëntor 1923 sigluan Marrëveshjen për Miqësi midis Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë. Në preambulën e saj thuhej shprehimisht: "Republika e Turqisë, nga njëra anë, dhe Shteti Shqiptar, nga ana tjetër, duke i marr parasysh lidhjet e vendosura midis dy popujve gjatë unitetit politik pesëshekullor turko-shqiptar dhe duke e proklamuar bindjen reciproke të tyre të sinqertë se ajo lidhje nga momenti i vendosjes së marrëdhënieve midis dy vendeve do t'i shërbej fatit dhe mirëqenies së dy popujve, kanë vendosur që midis vete të nënshkruajnë Marrëveshjen për Miqësi".

Çështja e riatdhesimit të shqiptarëve të shpërngulur në Turqi, përfshihej në Kreun III, nenin 3 të Marrëveshjes, ku thuhej: "Ata të cilët janë të kombësisë shqiptare e të cilët

deportohen në Turqi, ndërsa e kanë kaluar moshën 18 vjeç nga dita e implementimit të kësaj marrëveshjeje dhe në afat prej një viti, mund ta marrin shtetësinë shqiptare. Të gjithë ata të cilët shtetësinë shqiptare e marrin në këtë mënyrë, janë të detyruar që në afat prej një viti nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ta lëshojnë territorin e Turqisë, në marrëveshje se nuk mund të kthehen më në të, njëkohësisht duke e shitur pasurinë e tyre të tundshme e të patundshme si dhe të kryejnë të gjitha pagesat dhe borxhet shtetërore e private dhe t'i ndërpresin të gjitha lidhjet. Deri te lëshimi i kufirit turk, këta do të konsiderohen si shtetas të Turqisë".

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Turqisë, gjithsesi se nuk ishte në favor të politikës së atëhershme hegjemoniste jugosllave, prandaj ajo angazhoi diplomacinë e saj në Stamboll e Ankara, që të bëjnë çmos për ta penguar arritjen e marrëveshjes. Në këtë drejtim, më aktive ishte Konsullata në Stamboll, e cila për çdo ditë njoftonte Beogradin për rrjedhat e bisedimeve. Ajo më 19 nëntor i raportonte MPJ-së në Beograd, për gjoja dështimin e negociatave. Mirëpo, një lajm i tillë doli se ishte i pasaktë, sepse Marrëveshja për miqësi midis Turqisë dhe Shqipërisë, siç u tha më sipër, qe nënshkruar

më 18 nëntor, ndërsa ratifikimi i saj u la të bëhej pas zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, të cilat do të mbaheshin po atë vit në Shqipëri. Ngjarjet e ndodhura në Shqipëri gjatë vitit 1924, të cilat janë të njohura për opinionin e gjerë, ishin shkas për vonesën e ratifikimit të Marrëveshjes. E njëjta u nënshkrua më 16 korrik 1925, pasi në pushtet u kthye Ahmet Zogu.

Disa muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes për miqësi, Qeveria e Republikës së Turqisë hapi Legatën e saj në Tiranë. Po kështu veproi edhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e cila në janar të vitit 1926 emëroi diplomatit e shquar shqiptar, Rauf Ficon, për ministër të plotfuqishëm dhe i dërguari i jashtëzakonshëm shqiptar në Ankara, ndërsa Asafa Xhuxhulin për sekretar të parë të Legatës shqiptare në Stamboll. Nuk posedojmë të dhëna të detajuara për numrin e shqiptarëve të cilët kanë pranuar të riatdhesoheshin në Shqipëri, mirëpo dokumentet diplomatike jugosllave theksojnë qartazi për përpjekjen e pareshtur të Ahmet Zogut dhe të Qeverisë Mbretërore Shqiptare për riatdhesimin e tyre.

Kjo përpjekje nuk u ndal vetëm brenda afatit kohor të përcaktuar me marrëveshjen, porse vazhdoi edhe gjatë viteve të tridhjeta. Në shtator të vitit 1934, MPJ-ja jugosllave

publikoi raportin e konsullit të përgjithshëm shqiptar në Stamboll, F. Dervishi, në të cilën përshkruhet aktiviteti i asaj konsullate në lidhje me riatdhesimin e shqiptarëve nga Turqia, dhe jehona e madhe që asaj kohe kishte mbizotëruar në mesin e të shpërngulurve. Një aksion i tillë ishte ndërmarrë nga drejtori i Reformës Agrare i Mbretërisë Shqiptare, Hoxhë Sali Vuçitërna: "Me urdhër të asaj Ministrie dhe marrëveshjes gojore me drejtorin e Reformës Agrare, z. Sali Vuçitërnin, me rastin e ardhjes së tij në Stamboll, kjo përfaqësi nuk ka nguruar për ta zhvilluar aktivitetin e saj në mesin e emigrantëve nga Kosova të cilët gjenden në Turqi, që të kthehen në Shqipëri. Aktiviteti ka hasë në një sukses të plotë, aq shumë, saqë shumë familje kosovare, të cilët gjenden në Turqi, janë gati të nisen për Shqipëri. Në bazë të premtimeve të kësaj Konsullate, shumë prej tyre i kanë lënë vendet e tyre të caktuara nga ana e pushtetarëve turq dhe gjenden në Stamboll, të përgatitur për t'u nisur për Shqipëri. Shpenzimet e tyre të udhëtimit së bashku me shpenzimet e pasaportave, arrijnë shumën prej 4,000 frang ar".

Në kohën kur Qeveria shqiptare bënte përpjekje maksimale për riatdhesimin e një numri sa më të madh të shqiptarëve të dëbuar me dhunë nga jugosllavët,

autoritetet greke ndërmorën një veprim të dhunshëm në Çamëri, duke instaluar një numër të madh të emigrantëve të ardhur nga Turqia, nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Çamërisë. Për rrjedhojë, mira familje shqiptare të fshatrave të komunave Filat dhe Gumenicë, ishin regjistruar se dëshironin të shpërnguleshin për në Turqi.

Më 23 shkurt të vitit 1927, kryetari të Republikës, Ahmet Zogu, i arriti një letër nga Çamëria, në të cilën thuhej se çamët, për shkak vuajtjeve të shumta, "pa shkollë, pa kurrfarë të drejtë njerëzore, të keqpërdorun nga nëpunësit grek, duan të hikinë, masi po vuajnë aq keq dhe askush nuk i bije pas, çfarë të bëjnë?" "Duket sheshazi", vazhdon letra, "se Qeveria Greke do t'i shpërngul nga Çamëria. Prefekti i Janinës, duket se ka çue Hasan Hamitin t'i thotë, se po të nënshkruajnë një akt se Qeveria Greke nuk i forcon, por duan vet të iknë, nuk ka me u prue asnjë pengim. Sa për Qeverinë turke edhe kjo i pranon, po të kenë disa të holla me vete!"

Në vazhdim të letrës thuhet se "Qeveria greke do ta dërgonte një nëpunës të vet për t'i regjistruar shtëpiat dhe pronat e shqiptarëve të Çamërisë, ku një pjesë do i blente Banka e Azisë së Vogël, ndërsa pjesën tjetër Banka Kombëtare e Greqisë". Krejt në fund të letrës thuhej se "ky minoritet i gjakut ton, ka me e lanë





vendin e vet” për shkak dhunës që po përdoret nga autoritetet qeveritare greke, dhe se një pjesë e tyre “po t’i pranonte Shqipëria, do shkojshin të bëheshin nënshtrëtas Shqiptar”.

Gjendja në Çamëri u përkeqësua edhe më shumë gjatë muajve prill-maj 1927, pasi Qeveria greke, ashtu siç edhe kishte paralajmëruar, në shtëpitë dhe pronat e shqiptarëve vendosi një numër të madh të emigrantëve grekë nga Anadulli. Në një situatë të tillë, Dhoma e Deputetëve, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 1927, me propozim të deputetëve Maliq Bushati, R. Kiçi dhe Kol Mjeda, vendosi ta thërret Qeverinë e Shqipërisë për të dhënë shpjegime mbi padrejtësitë që po u bëheshin shqiptarëve të Çamërisë nga ana e Qeverisë greke. Në tekstin e propozimit thuhej se përkundër premtimeve dhe zotimeve të Qeverisë greke dhënë para Lidhjes së Kombeve, ajo, ndaj elementit shqiptarë në Çamëri po zbaton një politikë të dhunshme dhe antinjerezore. “Sipas principit të minoriteteve”, vazhdon teksti, “këta në vend që të gëzojnë të gjithë të drejtat si nënshtrëtas grekë, po ju mohohet e drejta ma natyrale principiale e drejta e gjallimit. Me planget e shtëpiat e këtyre të mjerëve, janë instaluar emigrandët e Anadollit të cilët me urdhën të Qeveris, gëzojnë krejt pasunin të këtyne si; bahçe, ullishta, kullosa dhe ara buke, tue i lanë të mjerët Çamë me vdekë nëpër udhë”!

Ndërkohë, Xhafer Çela, Zenel Ypi dhe Shahin Ypi, i shkruajnë një letër kryetarit të Republikës së Shqipërisë, Ahmet Zogut, në të cilën shprehin brengën e tyre të thellë, për shkak se, një pjesë bukur e madhe e çamëve; “janë duke e shitur pasurinë e tyre”, me qëllim që të shpërnguleshin për në Turqi. Marrë në përgjithësi, Qeveria greke, në emër të shkëmbimit të popullsisë me Republikën e Turqisë, dëboi me dhunë të gjithë banorët shqiptarë në 83 fshatra të Çamërisë. Lidhur me dëbimin e popullsisë shqiptare nga Çamëria, bën fjalë edhe analiza hartuar në vitin 1932, nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë së Mbretërisë Jugosllave, në të cilën veç tjerash, thuhet: “Në krahinën e Çamërisë, nga Epiri Verior, ka emigruar numri më i madh i popullsisë shqiptare vendore dhe është vendosur në Turqi dhe Shqipëri. Pasuria e tyre shumë e madhe ka ngelur në territorin e Greqisë. Këtë pasuri Greqët e kanë përvetësuar dhe ua kanë ndarë muhaxhirëve nga Azia e Vogël”.

Nga ana tjetër, autoritetet jugosllave, të frymëzuara nga Ligji për Kolonizim, të cilin Parlamenti turk e solli më 14 korrik të vitit 1934, që veç tjerash parashihte shpërnguljen e të gjithë turqve të Ballkanit për në Turqi, e panë si momentin kyç për shpërnguljen e tërësishme të popullsisë shqiptare e turke nga vatrata e tyre për në Turqi, dhe në tokat e tyre të vendoseshin kolonët sllavë.

Për këtë qëllim, Parlamenti jugosllav, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht të vitit 1934, bëri ndryshimin dhe plotësimin e nenit 55 të Ligjit për Shtetësi jugosllave, të miratuar gjatë vitit 1928, përmbajtja e të cilit ishte: “Josllavët të cilët në kuptimin e paragrafit të dytë të nenit 55, janë bërë shtetas të Mbretërisë, ndërpriten të jenë të tillë nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji e deri më 1 nëntor të vitit 1938, para organeve kompetente të pushtetit të shkallës së parë, ose në cilëndo përfaqësi tonën diplomatike apo konsullore në botën e jashtme, deklarojnë se tërhiqen nga shtetësia. Deklaratat të cilat i janë dorëzuar pushtetit të përmendur sikurse edhe përfaqësive diplomatike e konsullore nga ana e personave në fjalë, pas 1 nëntorit të vitit 1938, e deri në hyrje në fuqi të këtij Ligji, do të konsiderohen si të dërguara me kohë”!

Me këtë ligj, të gjithë shtetasit e Jugosllavisë që nuk ishin të përkatësisë etnike sllave, u “mundësohej” të merrnin shtetësinë e ndonjë shteti tjetër, dhe secili nga ata që merrte pasaportë të huaj dhe brenda vitit nuk largohej, atëherë autoritetet jugosllave e detyronte atë ta lëshoj Jugosllavinë. Në këtë mënyrë, një numër i madh i shqiptarëve, pasi Shteti shqiptar nuk i pranonte, u detyruan të shpërnguleshin për në Turqi, e cila, edhe pse deklaronte se nuk do t’i pranonte emigrantët shqiptarë nga Jugosllavia, ajo megjithatë

u ofronte të gjitha lehtësirat për t’u vendosur në Turqi.

Rrjedhimisht, në fillim të vitit 1935, tashmë dëgjoheshin lajme për marrëveshjen jugosllave-turke për shpërnguljen e myslimanëve, kuptohet, shqiptarëve etnikë. Ministri i Brendshëm i Turqisë, do të deklaroi se nga Republika e Turqisë do të sjell nga Jugosllavia 800 mijë emigrantë. Shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Jugosllavia për në Turqi, sipas diplomatit të shquar shqiptar, Rauf Fico, do të vazhdonte edhe më tej, sepse përbënte “interesin e përbashkët” turko-jugosllav, prandaj ai i propozonte Qeverisë Mbretërore Shqiptare që t’i ndërmerre të gjitha “masat e nevojshme për instalimin në Shqipëri” të atyre shqiptarëve, të cilët do të insistonin të linin Kosovën apo trevat tjera etnike shqiptare nën Jugosllavi.

Ndërkohë, konsulli i përgjithshëm jugosllav në Stamboll, në një analizë të hartuar në maj të vitit 1935, vlerësonte se Qeveria jugosllave nuk duhej ta popullarizonte shpërnguljen e popullsisë shqiptare për në Shqipëri, për arsye se me këtë rritej popullsia e atij shteti dhe përforcohej “lëvizja irredentiste”, e cila edhe ashtu nxitej nga vetë shteti shqiptar. Në vend të kësaj, ai propozonte që shqiptarët të shpërnguleshin për në Turqi, sepse sipas tij; “ai element shqiptar” i cili shpërngulet për në Turqi, llogaritet si “element i humbur përfundimisht”. Po në këtë periudhë kohore, Dhoma e Reformës Agrare në

Shkup filloi një fushatë të gjerë të konfiskimit të tokës pjellore nëpër vendbanimet shqiptare. Aksioni parashihte që “fshatarëve shqiptarë, t’iu lejohej vetëm 0,4 hektar tokë për një anëtar të familjes”. Qëllimi kësaj politike antishqiptare, siç njoftohemi nga burimet e shumta të proveniencës policore e ushtarake jugosllave, ishte “dëshpërimi i banorëve shqiptarë”, sidomos të fshatrave që shtriheshin buzë Malit Sharr e deri në hapësirën Kumanovë-Prishtinë, ku kompaktësia shqiptare ishte tepër e madhe. Autoritetet e Beogradit shpresonin që përmes këtyre masave të ashpra agrare, do t’i detyronin shqiptarët t’i braktisin vatrata e tyre e të shpërnguleshin për në Turqi.

I dërguari i Mbretërisë Shqiptare në Beograd, Rauf Fico, i shkruante MPJ-së se “me zbatimin e ligjeve të ndryshme të kolonizimit e të reformës agrare, me qindra familjeve shqiptare, u janë zaptuar tokat ashtu edhe banesat”, dhe se ky ishte shkaku i vërtetë i emigrimit të shqiptarëve për në Republikën e Turqisë. Në raportin plotësues të datës 18 maj 1934, R. Fico njoftonte MPJ-në se, autoritetet jugosllave më 25 mars 1934, kishin urdhëruar banorët e fshatrave të rrethit të Gjakovës: Batush, Nivokaz, Moglicë, Brovinë, Palabardh, Stubëll, Berjah, Ponoshec, Popoc, Shishman, Babaj Bokës se “nuk mundin ma që t’i punojnë tokat e tyre, të cilat mirën prej reformës agrare...”! /Memorie.al/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Khaka në mars i mungon Zvires, kjo është arsyeja

Në grumbullimin e parë të vitit, kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, nuk do të jetë i gatshëm për kombëtaren helveteke, e cila në mars zhvillon dy ndeshje miqësore. Siç njoftojnë mediae në Zvicër, 32-vjeçari nuk do të jetë i gatshëm për kombëtaren kur

do t'i zhvillojë dy duelet testuese më 21 mars kundër Irlandës Veriore dhe më 25 mars kundër Luksemburgut. Nuk bëhet fjalë për tërheqje nga kombëtarja apo ndonjë lëndim, por një marrëveshje ndërmjet Xhakës e për zgjedhësit Yakin, për një

arsye të veçantë. Gjatë kohës së grumbullimit të Zvicrës, Granit Xhaka pritet të bëhet baba për herë të tretë dhe për këtë arsye ka kërkuar leje të veçantë për të munguar gjatë kësaj kohe, që të qëndrojë afër familjes. Gazeta "Blick" raporton se ky do të ishte një pushim i

merituar për kapitenin e Zvicrës, pasi që nga gushti i vitit të kaluar e deri më tani ai i ka zhvilluar 39 ndeshje, apo mesatarisht një ndeshje në çdo pesë ditë. Për herë të fundit kur Xhaka ka munguar te kombëtarja ishte viti 2021, kur ai ishte i lënduar.



Sot derbi Prishtina - Drita



"Epoka e re"

PRISHTINË, 14 SHKURT - Sot (e shtunë) do të zhvillohen dy ndeshje të javës së 20-të në Superligën e Kosovës në futboll, kurse dy të tjera zhvillohen nesër (e diel). Kjo xhiro mbyllet të martën me ndeshjen në mes të Malishevës dhe Ferizajt.

Sot nga ora 17:00 në kryeqytet zhvillohet derbi në mes të Prishtinës dhe lideres aktuale të elitës, Dritës nga Gjilani. Të dyja këto skuadra janë kualifikuar në çerekfinale të Kupës dhe tash synojnë të vazhdojnë me fitore

edhe në Superligë. Drita është në formë të mirë. Nga nëntë ndeshjet e fundit triumfuese ka dalë në tetë prej tyre, por kjo nuk e zbeh aspak synimin e kryeqytetasve për të dalë fitimtarë. Po të njëjtën ditë do të zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Suharekës dhe Dukagjinit, e cila fillon nga ora 13:00. Këto dy skuadra janë eliminuar nga gara e Kupës dhe tash krejt fokusin e kanë në elitë. Të dielën, Gjilani, që u eliminua nga Kupa, e pret skuadrën kampione në fuqi, Ballkanin, derisa Feronikeli është nikoqir i Llapit. Këto dy ndeshje mjaft interesante do të zhvillohen nga

ora 13:00. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje zhvillohet ditën e martë nga ora 13:00. Do të përballen Malisheva dhe Ferizaj.

SUPERLIGA - Java e 20

Të shtunën takohen:
Suhareka - Dukagjini
Prishtina - Drita

Të dielën takohen:
Feronikeli 74 - Llapi
Gjilani - Ballkani

Të martën takohen:
Malisheva - Ferizaj

SHKURT

Neymari ëndërron rikthimin e madh te Barcelona

Neymari u rikthye në Brazil te Santos, skuadra ku u rrit si lojtar dhe me të cilën u bë i njohur në mbarë botën përpara se të transferohej te Barcelona. Ai do të qëndrojë deri më 30 qershor te Santos, por dëshira e tij është të rikthehet në Evropë. "Cadena SER" shkruan se sulmuesi brazilian do të kthehet edhe njëherë te Barcelona aty ku shkëlqeu për katër sezone përpara se të transferohej te PSG-ja dhe më pas në Arabinë Saudite. Për momentin nuk dihet vullneti i klubit katalanas edhe pse mund të ketë surpriza në verë.

Sylvinho në listën e Botafogos

"RTI Esporte" raporton se trajneri aktual i Shqipërisë, Sylvinho, është në listën e ngushtë të kandidatëve për ta marrë drejtimin e klubit të njohur brazilian Botafogo. John Texor, president i Botafogos, vazhdon bisedimet me Roberto Mançinin, ku italianin mësohet se ka kërkuar 500 mijë euro rrogë në muaj përveç bonuseve të tjera. Të dyja palët janë ende në negociatë, por nuk përjashtohet fakti që presidenti i Botafogos po vlerëson edhe kandidatë të tjerë. Një nga emrat që është në tavolinën e Texor është edhe ai i Sylvinhos, por për brazilianin që drejton kombëtaren e Shqipërisë nuk ka ende një propozim zyrtar deri tani. Sylvinho ka kontratë me Shqipërinë deri në fund të kualifikueseve të Botërorit dhe duket tërësisht i fokusuar për ta arritur objektivin historik që ka kombëtarja jonë siç është kualifikimi për herë të parë në një Kupë Bote.

Sistemit digjital 'MyFFK', presidenti Ademi pret në takim zyrtarët e Federatës së Futbollit të Arabisë Saudite

PRISHTINË, 14 SHKURT - Pas përfundimit të trajnimit disaditor për implementimin e sistemit digjital "MyFFK", presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka pritur në takim zyrtarët e Federatës së Futbollit të Arabisë Saudite, Mohamed Mansour dhe Khalid Alhëiti, përgjegjës të teknologjisë dhe inovacioneve, të cilët ishin në Kosovë për

këtë trajnim. "Ata ishin shumë të kënaqur me performancën e administratës së FFK-së, zyrtarëve të klubeve, delegatëve të ndeshjeve dhe Lidhjeve Rajonale, duke u larguar nga Kosova me përshtypjet më të mira që ky sistem shumë i avancuar tashmë ka gjetur zbatim në Kosovë", ka theksuar presidenti Ademi, duke i

falënderuar për dhurimin e këtij programi dhe gatishmërinë e tyre për të trajnuar të gjithë ata që do të punojnë me këtë sistem. "I njoftova se administrata e FFK-së, nga dita e hënë, ka filluar të punojë me këtë sistem, ndërkohë që nga qershori do të jetë obligativ edhe për të gjitha garat", ka shkruar Ademi në "Facebook".



Taulant Xhaka zbulon ëndrrën që dëshiron ta realizojë bashkë me vëllanë, Granitin

BASEL, 14 SHKURT - Skuadra zvicerane FC Basel humbi një legjendë. Taulant Xhaka e mbyll karrierën në verë. Arsyet dhe planet e tij për të ardhmen janë me vëllanë Granit Xhaka. Ëndrra e tij e madhe si futbollit nuk u realizua, të luajë sërish për

FC Baselin me vëllanë. Kjo nuk ishte vetëm ëndrra e Taulantit, ishte edhe e Granitit. Dhe kjo ishte ëndrra e shumë tifozëve të FCB. "Sigurisht që jam i trishtuar. Ishte një ëndërr e imja, por jam i lumtur që tani filloj një kapitull të ri,

atë të punës së trajnerit. Ndoshta një ditë do të punojmë me Granitin si trajner në FC Basel, unë si ndihmëstrajner i tij", ka thënë Xhaka për mediumin zviceran "90min". Nga njëra anë është licenca e trajnerit dhe ëndrra për të qenë

dyshe trajnerësh me vëllanë Granitin, por edhe Xhaka thotë se mezi pret të kalojë kohë me familjen dhe fëmijët. "FC Basel më ofroi mundësinë për të qëndruar në klub, por kam nevojë për distancë", ka shtuar Xhaka.



